




[www.ecdl-kosova.org](http://www.ecdl-kosova.org)

### **ECDL për Mësues dhe Profesor**

Aftësitë kompjuterike të përfituara përmes programeve të ECDL-së ju mundësojnë mësuesve dhe profesorëve përdorim të teknologjisë informative dhe komunikuese mënyrë efektive në procesin e mësimdhënies. Këto shkathtësi të përfituara ju ndihmojnë mësuesve dhe profesorëve të japin mësim në mënyrë efektive dhe në të njëjtën kohë ndihmojnë rritjen e produktivitet të nxënësve në klasë. Njohuritë digjitale rrisin produktivitetin duke u mundësuar mësuesve dhe profesorëve qasje dhe shpërndarje të materialeve mësimore në internet. Përdorimi i TIK-ut është metoda më e përshatshme e ligjërimit që rrit motivimin e nxënësve dhe studentëve në klasë.





## **Kursen Kohë**

Duke përdorur aplikacionet softuerike mësuesit dhe profesorët e kanë me të lehtë ta bëjnë punën e tyre profesionale, sepse këto aplikacione ua mundësojnë atyre:

- Menaxhimin elektronikë të të dhënave të studentëve në mënyrë efektive
- Pranimin dhe korigjimin e projekteve dhe detyrave në formë elektronike
- Komunikim me studentë dhe prindër
- Monitorimin e pjesëmarrjes dhe performancës së nxënësve
- Menaxhimin e regjistrimeve dhe të shpërndarjes së informacionit.

## **Rrit produktivitetin**

Aftësitë kompjuterike i ndihmojnë mësuesit dhe profesorët në kryerjen e lehtë të detyrave administrative, duke ju lënë kohë të mjaftueshme për t'u fokusuar në qëllime arsimore.

Posedimi i aftësive dhe shkathtësive të TIK-ut ju mundëson mësuesve dhe profesorëve të rrisin produktivitetin e tyre, duke:

- Krijuar plane mësimore
- Lehtësuar qasjen dhe shpërndarjen e informatave
- Krijuar përmbajtje mësimore interaktive (e-Learning)
- Përshtatur stileve të ndryshme të mësimit, dhe me përmbajtje adekuate
- Rritur motivimin e nxënësve përmes përdorimit të TIK-ut në klasë
- Ndajnë praktikat më të mira në internet duke rritur bashkëpunimin në mes të shkollave dhe universiteteve
- Komunikojnë me nxënësit duke përdorur email, mesazhe të menjëhershme ose bllogjet
- Shpërndajnë plane me kolegët dhe personelin
- Rrisin zhvillimin profesional dhe kënaqësinë në punë nëpërmjet rrjeteve profesionale.

## Shkollat dhe universitete

Shkollat dhe Universitetet duhet të bëjnë investime në teknologji informative dhe në aftësimin e stafit, mësuesve dhe profesorëve për përdorimin e këtyre teknologjive, sepse shkathtësitë digjitale paraqesin shkathtësi mbijetese të shekullit XXI. Domosdoshmëria e investimeve të tilla është kuptuar nga politik-bërësit e vendeve të zhvilluara në Evropë e më gjerë. Komisioni Evropian në agjendën digjitale për Evropë e bën krijimin e kornizave vlerësuese të shkathtësive digjitale obligative për të gjitha shtetet e BE-së. Kjo u pasua në shumë shtete me politika konkrete të certifikimit të shërbyesve civil, arsimtarëve dhe nxënësve me programe të ECDL-së. Një shembull i tillë është ai i vitit 1999, kur u nënshkrua një marrëveshje në mes të ECDL Foundation dhe Ministrisë së Arsimit të Italisë duke e bërë ECDL-në standard zyrtar për vlerësimin e aftësive kompjuterike në sistemin arsimor Italian. Në marrëveshje u përfshin të gjitha shkollat dhe universitetet në nivel kombëtar. Që nga 2011, përafërsisht 640,000 kandidatë nga sektori shkollor publik dhe rreth 200.000 studentë të universiteteve janë certifikuar me ECDL.

## Dobitë e shkollave dhe Universiteteve nga ECDL

Arsimi duhet t'u përshtatet ndryshimeve të vazhdueshme të teknologjisë, dhe t'i përdorë ato gjerësisht në procesin mësimor. Këtyre ndryshimeve arsimi duhet t'u përgjigjet, me ritme të shpejta, me zhvillime të brendshme sasiore e cilësore për të transmetuar njohuri e aftësi sistematike, koherente e të qëndrueshme të nxënësit, duke i reflektuar më pas këto në shoqëri për krijimin e një të ardhmeje më pozitive për të gjithë.

ECDL ndikon në mësimdhënien e suksesshme dhe u krijon mundësi mësuesve dhe profesorëve për të mësuar dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin, nëpërmjet shkëmbimit të ideve, përvojave dhe zgjidhjes së problemeve të përbashkëta pedagogjike. Të gjithë e dimë që mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Për të qenë më efikas në punën e tyre, mësuesve dhe profesorëve nuk iu mjafton të zotërojnë vetëm lëndën; ata duhet të dinë ta transmetojnë atë sa më lehtësisht të nxënësit dhe studentët, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore e mu këtu hyjnë në lojë shkathtësitë digjitale të përfituara nga programet e ECDL-së.





## Universitetet që kanë njohur ECDL-në

ECDL është e njohur nga shumë Universitete të njohura botërore si, Universiteti i Oksfordit, Universiteti i Kembrixhit, Universiteti i Londrës, Universiteti i Bristolit, Universiteti i Mançesterit e shumë universitete të tjera.

## Për ne

ECDL Kosova është autoriteti nacional certifikues i autorizuar nga ECDL Foundation për Republikën e Kosovës. ECDL Foundation është autoriteti mbikëqyrës i programeve certifikuese, ndërkombëtarisht prijëse, të shkathtësive kompjuterike – ECDL/ICDL. Cilësia dhe reputacioni i programeve tona certifikuese janë të ndërtuara mbi përvojën e gjatë në shpërndarjen e suksesshme të programeve certifikuese të TIK-ut miliona njerëzve anëmbanë botës në më shumë se 41 gjuhë të ndryshme dhe në mbi 150 shtete.

Suksesi global i ECDL-së rrjedh nga roli ynë nismëtar në identifikimin dhe zhvillimin e programeve si dhe përkushtimin tonë për të siguruar metodologji testuese që, në mënyrë të vazhdueshme, i zbatojnë standardet më të larta të cilësisë.

Programet certifikuese të ECDL-së në Kosovë janë të njohura nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Universitetet Publike dhe Private dhe një numër i madh i organizatave dhe institucioneve private e publike (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Pushtetit Lokal, Policia e Kosovës, FSK, Inspektorati Policor, Autoritetet Rregulluese, Firma e Organizata private e jo-qeveritare).

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Integritimit Evropian përmes planit për veprim PVPE 89/2 e pozicionon ECDL-në si standard certifikues për të gjithë shërbyesit civil. MASHT, duke filluar nga viti 2009 e ka përfshirë certifikimin ECDL Standard si masë obliguese për licencim për të gjithë mësimdhënësit e shkollimit para-universitar.

## A mund të ju ndihmojmë?

Për çfarëdo informate shtesë jemi në dispozicionin tuaj në çdo kohë.

Ne mund të na gjeni në këtë adresë:

ECDL Kosova SH.A.

Rruga Xheladin Hana p.n. – Bregu i Diellit

10000 Prishtinë

**Internet: [www.ecdl-kosova.org](http://www.ecdl-kosova.org) Email: [admin@ecdl-kosova.org](mailto:admin@ecdl-kosova.org) Phone: 044-507 575**